

B. 2. Opinonet e nxënësve

Florida Misini,
nx. e kl. V
në skollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit



"...Për mua këto metoda janë mjaft interesante. Mësimi është mjaft i kuptueshëm si për mua ashtu edhe për shokët dhe shoqet..."

Bujare Ahmeti,
nx. e kl. V
në shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit




"...Metodat e reja për mua janë shumë të dobishme për të kuptuar mësimin. Shumica e arsimtarëve i përdorin këto metoda..."

Aida Hamza,
nx. e kl. VIII
në shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit

"...Çdo orë punojmë në grupe,...përgjigjemi bashkarisht. Kur nxënësi përgjigjet arsimtari pyet në hollësi dhe nese vetëm një e di punohet pastaj në grup. Puna në grupe është më e mirë sepse më shumë mbahet në mend dhe i ndimohet atij që nuk di..."

Amanda Selmani,
nx. e kl. VI
në shkollën fillore
"N. Berati"
të Dragashit




"...Mendoj se kështu është shumë mirë. Punojmë me shokët e shoqet dhe çdo gjë më shkon mirë. Shokët dhe shoqet më ndihmojnë kur unë nuk di diçka por edhe unë i ndihmoj ata. Disa nxënës më parë nuk kanë ditur mirë tani po...
Unë mendoj se prej kur kam nisur shkollën kjo mënyrë e punës nuk ka ekzistuar."

Dafina Gllogjani,
nx. e kl. VII
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës

"...të gjithë nxënësit janë të njejtë dhe bashkëpunojnë njëri me tjetrin. Tani nxënësit mund t'i shprehin mendimet e tyre. Këto metoda i ndihmojnë edhe nxënësit më të dobët... Tani idetë e nxënësit janë të mirëpritura te mësuesi. Jemi të gëzuar që këto metoda arrijnë në shkollën tonë..., të gjithë nxënësit janë të kënaqur me to."

Furtuna Berisha,
nx. e kl. VII
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"... Ora është më atraktive, nxënësit janë shumë më të interesuar... Nxënësit e kanë fjalën e lirë, arsimtari respekton mendimet e secilit. Nxënësit kanë filluar ta "çelin gojën". Kjo ide është e shkëlqyer dhe po funksionon mirë. Gjithashtu, marrëdhëniet me arsimtarë janë më të mira. Mësuesi i mëparshëm më shumë ka folur se sa që i ka dëgjuar mendimet e nxënësit, kurse tani është e kundërta..."

Florentina Kaliqani,
nx. e kl. VIII
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës

"...Unë jam e kënaqur që bashkëpunojmë në grupe së bashku me shokët e klasës prandaj kam dëshirë që kjo metodë të vazhdojë kështu... Ne bashkëpunojmë në grupe, secili shpreh mendimin e vet dhe njëri prej tyre zgjedhet udhëheqës i grupit... Kam përshtypje të për këtë metodologji të re dhe mendoj se duhet të vazhdohet."


Jeta Pajaziti,
nx. e kl. VIII
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës

"...Tani çdo gjë është ndryshe. Për dallim nga më parë ne tani mësojmë në grupe, pyetemi me teste dhe i shprehim mendimet tona hapur..."

Fisnik Ukaj,
nx. i kl. VIII
në shkollën fillore
"V.P.Shkodrani"
të Pejës

"Unë jam tepër i kënaqur me metodat e reja që kanë filluar të vihen në jetë...Me këto metoda çdo nxënës gëzon të drejtën e tij për shprehjen e lirë të mendimit pa marrë parasysh nese mendimi është i saktë apo i gabuar. Nxënësit prej se janë aplikuar këto reforma e metoda janë shumë të aktivizuar."

Ilire Gjuka,
nx. e kl. VII
në shkollën fillore
"V.P. Shkodrani"
të Pejës



"Zbatimi i metodave të reja është hap i parë drejt përparimit për arsimin dhe në kulturën shqiptare... Ka shumë ndryshime në krahasim me mësimin e viteve të kaluara. Orët janë më të lira dhe mund t'i shprehim lirshëm mendimet tona..."

B. 3. Opinionet e prindërve

Indire Rifaj,
prind




"...Po vërehet një ndryshim te fëmijët e mi, do të thotë shumë më lehtë po kuptojnë dhe janë më të kënaqur sidomos me punën në grupe, po vërej një vullnet. Jemi të kënaqur dhe dëshirojmë që edhe më tutje të punohet në këtë drejtim."

Maliq Ahmeti,
prind



"...Unë si prind i dy fëmijëve, kam hetuar se metodat e reja të mësimit që zbatohen nga arsimtarët e lëndëve të ndryshme kanë sjellë një freski të re te fëmijët e mi...Tani interesimi i fëmijëve është më i madh për të mësuar dhe punuar në mënyrë më të përkushtuar prandaj dëshiroj që këto teknika të mësimit të vazhdojnë edhe më tej."

Softiq Hajriq,
prind



"...Mund të them se jam i kënaqur me metodat e reja të të nxënit të cilat i përdorin arsimtarët.Fëmiu im është plotësisht i kënaqur dhe vetëm pret që të shkojë në shkollë. Si fëmija im ashtu edhe unë personalisht dua të them se i falenderoj për çasjet ndaj fëmijës tim."

Qazim Lutvija,
prind

"...Në shumë aspekte vajza ime tani ndryshon, prej se përdoren metodat e reja: tregon shumë interesim për mësim dhe shkollë, angazhohet më shumë në shtëpi, tregon aktivitet shumë më të lartë se deri më tani, parashtron pyetje logjike, kuptime të drejta...shumë ka përparuar në mësim.
Mendoj se metodat e reja në mësim shumë më shumë kontribuojnë në zhvillimin dhe arsimimin e gjithanshëm të nxënësit."